



NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Broker/Specialist Sigurimesh/Specialist Prokurimesh”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “Ekipe Sportive 2022”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin “Broker/Specialist Sigurimesh / Specialist Prokurimesh”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Broker/Specialist Sigurimesh / Specialist Prokurimesh

Kërkohen dy Specialistë Sigurimesh/Broker të aftë për të hartuar terma reference teknike për sigurimin shendetesor nga aksidentet ne sport si dhe për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar fakultetin - degë të lidhura me fushën e veprimit;
- Të paktën 3 vite eksperiencë profesionale në fushën e sigurimeve si specialist apo broker.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e termave të references për sigurim shendetesor, preferohet për Siguracion Shendetesor për aksidentet Sportive.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze.



Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira në shkrimin e specifikimeve teknike në përgjithësi;
- Të zotrojnë në nivel shumë të mirë "Paketën Office";
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 06 Dhjetor 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Broker/Specialist Sigurimesh/Specialist Prokurimesh.**